



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY  
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Nr. ref. 01 / 1157a Datë: 21. 09. 2020


Senati i Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, në bazë kompetencave të përcaktuara sipas nenit 99 të Statutit të Universitetit si dhe vendimit të MASH, Nr. 2266 dt.17.09.2020 për aprovimin e kuotave për regjistrimin e studentëve të rinj në UKZ, vendosi për shpalljen e

## KONKURSI

për pranimin e studentëve të rinj, në vitin e parë të studimeve themelore baçelor në vitin akademik 2020/2021

### I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan, në vitin e parë të studimeve, në afatin e parë të konkursit për vitin akademik 2020/2021, do të regjistrojë 780 studentë të rregullt në studime baçelor.
2. Nga numri i përgjithshëm i përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 MASHT-it, Universiteti do të regjistrojë deri në 12 %, përkatësisht deri 93 studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej 12% të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
3. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHT-i, mund të pranohen edhe kandidatët nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja 2% . Numri i studentëve të rregullt që do të pranohen si në paragrafin 1 të pikës I është deri 17 studentë . Kandidatët të cilët kanë lindur në vendet e sipërshehuara, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë kryer në ato vende .
4. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHT-i, mund të pranohen edhe 2 % e kandidatëve nga Shqipëria dhe Maqedonia, përkatësisht 17 studentë të rregullt, për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
5. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHT-i, mund të pranohen 1 % të kandidatëve nga Mali i Zi, përkatësisht 8 studentë të rregullt, për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
6. Universiteti do t'i ketë në konsideratë në mënyrë të veçantë edhe kandidatët me nevoja të veçanta të cilët e kalojnë prapen e provimit pranues.
7. Të drejtë pranimi në Universitetin "Kadri Zeka" kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë apo jashtë Kosovës dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
8. Kandidatë jo-kosovarë konsiderohen kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës dhe me rastin e paraqitjes në konkurs, duhet të verifikohet njohja e institucionit shkollor në bazë të listës së MASHT-it, e cila u dorëzohet të gjitha njësive akademike.
9. Kandidatet te cilët kane diploma jashtë Kosovës duhet ta bëjnë nostrifikimin e tyre në MASHT.
10. Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetë deklaram.
11. Njësitë akademike përkatëse me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti jo-shumicë bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.



12. Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetë deklaram, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR. 04/L-082) të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale.
13. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në kuadër të Universitetit “Kadri Zeka” nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.
14. Kandidatët për pranim si student në Universitetin “Kadri Zeka” në vitin akademik 2020/21 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet, departament, drejtim apo program.

## II. AFATET E KONKURISIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve baçelor , oraret do të jenë si në vijim:

1. Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës 21.09.2020 deri më 30.09.2020 nga ora 9.00 deri në orën 16.00 në shërbimet për studentë të fakulteteve përkatëse (dokumentet do të pranohen çdo ditë me përjashtim të dielave).

**Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:**

- a) *Ekstraktin e lindjes (original),*
- b) *Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (original ose të noterizuara),*
- c) *Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme ose dëftesën e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (original ose të noterizuar), për studime baçelor*
- d) *Kopjen e letërnjoftimit,*
- e) *Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit. (vendimi bëhet në MASHT)*
- f) *Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti:*
- g) *Vegza (Linku) për konkurrim online përmes Internetit është: <http://uni-gjilan.net>*
- h) *Pagesën prej 2.5 Euro. Forma e pagesës shkarkohet dhe shtypet nga ueb-faqja e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan , ndërsa pagesa bëhet në bankë.*

Dokumentet nën pikën b/ dhe c/ mund të pranohen dublikatë vetëm nëse dëshmohet me vërtetim të organeve kompetente për humbje, dëmtim, vjedhje etj.

***P.S. Pas nxjerrjes së dokumenteve dublikatë, dokumentet origjinale nuk mund të shfrytëzohen nga kandidati pasi që ky veprim konsiderohet vepër penale.***

1. Njoftimet dhe oraret për vendin ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në fakultetet përkatëse, si dhe në ueb-faqet e universitetit.
2. Provimi pranues do të mbahet të premtën më datë 02.10.2020 për Fakultetin Juridik, Shkencave Kompjuterike dhe Fakultetin e Shkencave Aplikative. Kurse për Fakultetin e Edukimit dhe Fakultetin Ekonomik provimi pranues do të mbahet të shtunën më 03.10.2020.  
***Koha e saktë e mbajtjes së provimit, lista e kandidatëve dhe numri i sallave do të publikohen në ueb faqe të Universitetit të enjten më 01.10.2020.***
3. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet ta posedojnë letërnjoftimin, pa të cilën nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues.  
***Në kohën e mbajtjes së provimit pranues kandidatët nuk mund të kenë pranë vetes telefona celularë dhe asnjë mjet tjetër teknologjik.***
4. ***Shpallja e rezultateve të provimit pranues do të bëhet, më së voni, deri të martën datë 6 tetor 2020 në fakultetet përkatëse si dhe në ueb-faqen e universitetit.***
5. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.
6. Në departamentet, degët, drejtimet ose programet ku nuk plotësohet numri i kandidatëve të paraparë me këtë konkurs, do të shpallet konkurs plotësues.
7. Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'u drejtohen fakulteteve përkatëse ose ta vizitojnë faqen e internetit: [www.uni-gjilan.net](http://www.uni-gjilan.net)



### III. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kritereve si në vijim:
  - a) Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:  
Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
    - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë; dhe
    - Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.
  - b) Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:  
Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
    - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
    - Suksesi në maturë deri në 30 pikë;
    - Suksesi në provimin pranues deri në 40 pikë.
2. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
3. Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
4. Kandidatët nga Lugina e Preshevës, Shqipëria, Maqedoni, Mali i Zi dhe komunitetet, mund të rangohen në listën e të pranuarve nëse kanë arritur së paku 30% të pikëve nga provimi pranues.
5. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatët tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta atëherë do të merret parasysh suksesi i shkollës mesme. Në qoftë se edhe suksesi është i njëjtë atëherë përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femërore.
6. Regjistrimi i studentëve të pranuar në vitin e parë, bëhet në administratën e njësive akademike, sipas orarit të përcaktuar me këtë konkurs.

### IV. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË

1. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve. Pas këtij afati, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave nga fakulteti përkatës më datë 8 tetor 2020 duke filluar nga ora 10.00.
2. Më 9 tetor 2020 publikohen rezultatet përfundimtare.
3. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës nga data **09.10.2020** deri më 13.10.2020.

### V. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE TË PRANUAR

4. Regjistrimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet në administratën dhe fotografimi në zyrat e TI sipas këtij orari:
  - Fakulteti i Edukimit, më datë **12.10.2020** prej orës 9.00 deri në orën 16.00;
  - Fakulteti Ekonomik, dhe i Shkencave Aplikative më datë **13.10.2020** prej orës 9.00 deri në orën 16.00
  - Fakulteti Juridik, dhe i Shkencave Kompjuterike më datë **14.10.2020** prej orës 9.00 deri në orën 16.00.
5. Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen, prandaj luteni që t'i përmbaheni afatit të lartshënuar.
6. **Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:**
  - a) Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit,



- b) Dy fotografi (formati 4.5 x 6 cm), të cilat duhet të jenë sipas normave dhe rregullave për dokumente personale.
- c) Studentët shtetas të Republikës së Kosovës që fillojnë studimet në Universitetin “Kadri Zeka”, vitin e parë të studimeve bachelor e kanë falas.
- d) Pagesa për një semestër për studentë që nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës, do të jetë në lartësi prej 25 € për studime të rregullta, sipas Udhëzimit Administrativ nr.17/2014 të datës 6.05.2014.
7. Pagesa bëhet në njërin prej bankave afariste me fletëparaqitje për pagesë, e cila shkarkohet dhe shtypet nga Ueb faqja e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan.

### STUDIMET BAÇELOR

Tabela me numrat e paraparë për studentë të rinj për vitin akademik 2020-2021 sipas njësisive akademike dhe programeve

Fakulteti	Programi	Nga Kosova	Lugina e Preshevës 2%	Komunitetet jo-shumicë 12%	Shqipëria & Maqedonia 2%	Mali i Zi 1%	Gjithsej
Edukim	Fillor	101	2	14	2	1	120
	Parashkollor	65	2	10	2	1	80
Ekonomik	Banka Financa dhe Kontabilitet	166	4	24	4	2	200
	Menaxhment dhe Ndërmarrësi	83	2	12	2	1	100
Juridik		149	4	21	4	2	180
Shkenca Kompjuterike		61	2	9	2	1	75
Shkenca Aplikative	Matematikë Arsimore	20	1	3	1	0	25
<b>TOTAL</b>		<b>645</b>	<b>17</b>	<b>93</b>	<b>17</b>	<b>8</b>	<b>780</b>

#### I. FAKULTETI I EDUKIMIT

##### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të degëve mësimore të fakultetit dhe atë:

- **Programi Fillor:** Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Edukatë qytetare
- **Programi Parashkollor:** Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Edukatë qytetare

#### II. FAKULTETI EKONOMIK

##### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të departamentit përkatës të fakultetit dhe atë:

- **Fakulteti Ekonomik (Të gjitha drejtimet):** Hyrje në ekonomi dhe Matematikë

#### III. FAKULTETI JURIDIK



PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e fushës së ngushtë profesionale të degës përkatëse të fakultetit dhe atë:  
- Fillet e së drejtës, E drejta kushtetuese dhe Edukatë qytetare.

**IV. FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE**

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Informatikë dhe Matematikë.

**V. FAKULTETI I SHKENCAVE APLIKATIVE**

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Matematikë

